



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSEHM

	Përmbajtja	Faqe
I.	Përmbledhje Ekzekutive	2
II.	Baza Ligjore	2-3
III.	Organizimi	3
	• Misioni i auditimit të brendshëm	3
	• Organizimi i NJAB	3
IV.	Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm	3-10
	• Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese	3-5
	• Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve.....	5
	• Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre	5-8
	• Gjetjet kryesore sipas sistemeve.....	8-10
	• Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.....	10
	• Çështjet e dërguara për investigim.....	10
V.	Rekomandimet	10-14
	• Rekomandimet e propozuara	10-13
	• Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit	14
VI.	Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë	14
VII.	Analiza e Kapaciteteve Audituese	14-15
	• Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB	14
	• Kapacitetet audituese	14-15
	• Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve	15
	• Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve	15
VIII.	Konkluzione	15-16
	• Konkluzione mbi problematikën e punës audituese	15
	• Prioritetet për vitin në vazhdim	15-16

**MIRATOHET
SOTIRAQ FILO****KRYETAR I BASHKISE****I. Përmbledhje Ekzekutive**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Bashkisë Korçë, përcjell sipas kërkesave dhe standarteve të auditimit, Raportin e vitit 2022, për veprimtarinë e saj Janar- Dhjetor 2022, sipas detyrimit të pikës ç të nenit 14 të Ligjit nr. Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ky raport pasqyron përmbushjen nga Drejtoria të aktiviteteve të auditimit të realizuara për vitin 2022, në krahasimin me detyrimet e planifikuara dhe objektivat e caktuara.

Raporti gjithashtu siguron të dhëna statistikore të paraqitura në tabelat bashkëlidhur dhe të hartuara sipas formateve të unifikuara nga Drejtoria e Harmonizimit për AB, në Ministrinë e Financave, në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, date 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, duke specifikuar një sërë treguesish të arritur, të dalë nga raportet e auditimeve të përfunduara për këtë vit.

Përveçse qëllimit raportues këta tregues të cilët pasqyrojnë performancën e punës së drejtorisë, do të jenë objekt i analizës së performancës, vlerësimit të cilësisë së shërbimit, etj për të siguruar një tendencë pozitive në rritje të treguesve në terma afatshkurtër e afatgjatë.

Të gjitha subjektet e audituara, i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, duke dëshmuar se ato kanë qënë të duhurat dhe se kanë ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e vlerës së subjekteve publike.

Përpyekjet e Drejtorisë së Auditimit do të vijojnë për të përmbushur auditime me nivel të lartë profesional, duke realizuar qëllimet dhe objektivat vjetore dhe strategjike.

II. Baza Ligjore

Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Ligji për Buxhetin vjetor të shtetit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave për zbatimin e tij.

Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ligji nr.152/2013, datë 26.02.2014 “Për Nëpunësit Civil”, me ndryshime.

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,

Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në RSh”, me ndryshimet përkatëse.

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

VKM nr. 285, datë 99.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin e MF nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Kodi i etikës për AB në sektorin publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.86, dt.10.12.2015.

Karta e AB e bashkisë Korçë miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.257, dt.15.04.2021.

Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të AB për bashkinë Korçë, miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.376, dt.28.05.2021.

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

Rregullorja e Bashkisë Korçë e miratuar nga kryetari i bashkisë për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë, si dhe të gjitha rregulloret e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë.

III. Organizimi

• Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është t'i japë siguri të arësyeshme kryetarit të Bashkisë, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në bashkinë Korçë dhe në institucionet e vartësisë, duke :

- Zbatuar standartet e auditimit dhe sigurimin e cilësisë.
- Dhënë rekomandime për përmirësimin e performancës dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut për fondet publike.
- Vlerësuar transparencën në përdorimin e fondeve e duke këshilluar menaxherët për të përmirësuar bashkëpunimin midis strukturave.
- Dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemeve.
- Monitoruar, mbikëqyruar, analizuar dhe vlerësuar auditimet e kryera.
- Parandaluar shkeljet e parregullsitë, zbuluar ato dhe duke ndihmuar menaxhimin në plotësimin e objektivave.

• Organizimi i NJAB

Në zbatim të gërmës a, pikës 1 të nenit Nr.10 të Ligjit Nr.114/2015, datë 22.10.20 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” drejtorja e auditimit ka strukturë :

Drejtor	1
Auditues	3
Gjithsej	4 punonjës

Për vitin 2022 në këtë drejtori ka patur 1 drejtor dhe 2 auditues. Theksoj se një auditues i ri është në proces çertifikimi. Në krahasim me strukturën e miratuar, mbetet me 1 punonjës më pak.

Vartësia e njësisë së auditimit është nga Titullari i Institucionit (Kryetari).

Arsimi profesional i punonjësve është: 1 ekonomiste finance dhe 1 ekonomiste plani dhe 1 ekonomiste financë-kontabilitet, në përputhje me kriteret e përcaktuara me përshkrimet e vendeve të punës që aplikohet për strukturat e auditimit. Drejtorja e kësaj Drejtorie dhe një audituese janë të çertifikuara. Punonjësja tjetër është në proces çertifikimi nga MFE.

Niveli profesional i drejtores dhe i një autiteje është shumë i mirë.

Njësia e Auditimit e shtrin auditimin në aktivitetin e drejtorive të Bashkisë, Institucionet dhe Nd-jet e vartësisë.

IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

• Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Për vitin 2022, pas rishikimit të planit vjetor të miratuar nga kryetari i bashkisë në dt.03.10.2022, janë planifikuar 6 auditime gjithësej dhe janë realizuar 4 auditime sipas tabelës :

NR	SUBJEKTI I AUDITUAR	REALIZIMI po/jo	SHPJEGIME
1	BASHKIA - Prokurimet	Po	
2	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara në vitin 2021.	Po	
3	BASHKIA - Sherbimi i varrezave publike	Po	
4	Qendra rezidenciale e zhvillimit	Po	
5	BASHKIA- Sektori i integritetit europian, projekti LED, financuar nga fondet IPA.	Po	
6	BASHKIA - Financa për detyrimet e prapambetura	Po	
	TOTALI	6	

Në fund të periudhës 9 mujore, duke parë ecurinë e angazhimeve të zhvilluara, i është kërkuar kryetarit të bashkisë të miratojë ndryshimin e planit fillestar të auditimeve, i cili ka miratuar ndryshimet në dt.03.10.2022.


Ndryshimi i planit të angazhimeve për vitin 2022, është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të AB me shkresat nr.8836, dt.14.10.2022.

Arësyet e rishikimit të planit fillestar dhe ndryshimi i tij për vitin 2022, kanë qënë :

- Mungesën e stafit të kualifikuar, një nga auditueset është e re në profesion dhe e pa çertifikuar.
- Ndryshime të subjektit për shkak të problematikave të lindura gjatë vitit.
- Sugjerimin e DHAB për audimin e projekteve me fonde të huaja.
- Auditimin nga KLSH te bashkisë dhe insitucioneve të vartësisë.

Angazhimi i parashikuar në planin fillestar për auditim performance në fushën e Shërbimit urban, u zëvendësua me auditim përputhshmërie në fushën e Shërbimit të Mirëmbajtjes së varrezave Publike dhe varrezave të dëshmorëve, ndërsa auditimi i performancës në fushën e Shërbimeve në njësi administrative e rajone, u zhvendos për tu audituar në vitet pasardhëse.

Në grafikun e mëposhtëm jepet një realizim i auditimeve të planifikuara në tre vitet e fundit, 2019-2020-2021



Arësyet e ndryshimeve të planit vjetor në këto tre vite kanë ardhur për arsye të :

1. Mbivendosjes së auditimeve të planifikuara me auditimin e jashtëm KLSH.
2. Mungesës së plotësisë të njësisë me auditues sipas strukturës së miratuar.
3. Kërkesave të titullarit për auditime të paparashikuara në planin vjetor.

4. Njohjes e përditësimit të ndryshimeve të bazës ligjore, sidomos për Vetëqeverisjen vendore, MFK dhe Auditimin e Brendshëm.
5. Situata e pandemisë COVID-19, në vitin 2020
6. Ndryshime të subjektit për shkak të problematikave të lindura gjatë vitit.
7. Mungesën e stafit të kualifikuar, një nga auditueset është e re në profesion dhe e pa çertifikuar.
8. Ndryshime të subjektit për shkak të problematikave të lindura gjatë vitit.
9. Hyrjen në fuqi të Udhëzimit nr.42, dt.27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin Publik”.
10. Sugjerimin e DHAB për audimin e projekteve me fonde të huaja.

- **Analiza e misioneve të auditimit**

Për vitin 2022, janë kryer gjithsej 6 angazhime auditimi, 3 angazhime përputhshmërie, 1 angazhim performance dhe 2 angazhime të kombinuara (përputhshmërie e financiar).

Janë evaduar 5 raporte auditimi. Pasqyra nr.2 bashkëngjitur këtij raporti jep realizimin e planit të angazhimeve për vitin 2022.

- **Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre**

Për vitin 2022 angazhimit e auditimit janë përqëndruar kryesisht në fushat e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në subjektete e audituara në vitin 2020, e burimeve njerëzore, të shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura të bashkisë dhe fushën e projekteve të financuara me fondet IPA.

Vlerësimi i riskut për këto fusha në vitin 2022 ka qënë :

- Drejtoria e Prokurimeve në bashki – risku i lartë.
- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në subjektet e audituara në vitin 2021 – risku i lartë, si çështje kryesore e ngritur nga aktorët ndërkombëtarë.
- Shërbimi i varrezave publike në bashki dhe NSHP – risku i mesëm, por dolën problematika gjatë vitit 2022.
- Qendra rezidenciale e Zhvillimit – risku i mesëm, por ishte shtyrë nga viti 2021.
- Sektori i integritetit europian, projekti LED me fondet IPA – risku i lartë, si çështje kryesore e ngritur nga aktorët ndërkombëtarë.
- Shlyerja e detyrimeve financiare të prapambetura të bashkisë – risku i lartë, si çështje kryesore e ngritur nga aktorët ndërkombëtarë.

Nga auditimet e kryera ka rezultuar si vijon :

- Fusha e Prokurimeve Publike, vazhdon të mbetet një fushë me risk të lartë për shkak të numurit të shumtë të procedurave të zhvilluara dhe të ndryshimeve ligjore. Kanë rezultuar mangësi në: Plotësimin e strukturës me personelin e miratuar, pasi kjo rrit risqet për mospërbushjen e objektivave, e për rrjedhojë bie efica dha efektiviteti i burimeve njerëzore në dispozicion. Hartimin e një programi për monitorimin e aktiviteteteve. Llogarritjen e saktë të fondit limit, sipas manualeve teknike sidomos për transportin e druve të zjarrit me kafshë. Përzgjedhjen nga KVO të operatorëve ekonomikë fitues, sipas kërkesave ligjore. Caktimin e anëtarëve të Njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit ose të KVO, si përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.
- Fusha e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në subjektet e audituara në vitin paraardhës, është një fushë me risk të lartë për shkak të nivelit të ulët të zbatimit të rekomandimeve të AB nga subjektet e audituara.

Nëpërmjet këtij angazhimi monitorohet dhe ndiqet zbatimi i rekomandimeve duke i sjellë ato edhe njëherë në qendër të vëmendjes për menaxhimin e subjektit të audituar.

Vlerësohet gjithashtu nëse gjetjet e auditimit janë adresuar në mënyrën e duhur.

Vlerësohet sa efektive e të përshtatshme janë masat e marra nga titullari i subjektit për të korrigjuar e parandaluar veprimet për të ardhmen.

Vlerësohet zbatimi i afateve të vendosura e të pranuar dhe personave përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.

Vlerësohet zbatimi i planit të veprimit që ka përgatitur cdo subjekt për zbatimin e rekomandimeve dhe komunikimin e subjektit me AB për të dhënë informacion për zbatimin e rekomandimeve.

Në përfundim të këtij angazhimi nga **36** rekomandime të dhëna në vitin 2021, **25** prej tyre janë zbatuar dhe kanë mbetur në proces zbatimi **11** prej tyre.

- Fusha e Shërbimit varrimit publik, që përfshin realizimin me efikasitet e përgjegjësi të shërbimit të varrimit për komunitetin, duke ndjekur zbatimin e kontratës të nënshkruar me operatorin fitues, brënda afateve dhe kushteve të përcaktuara në procedurën e prokurimit, ka rezultuar me mangësi në:

Plotësimin e vendeve vakante në personelin e drejtorisë sipas strukturës së miratuar;

Zbatimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm si përditësimi i rregullores së NSHP për pozicionin e kartelistes, pozicioni përgjegjës për zbatimin e ligjit në fushën e shërbimit të varrimit.

Rregjistrimin e varrezave publike si pronë e bashkisë.

Rregjistrimin në 2 rregjistra të çdo shërbimi varrimi dhe nënshkrimin e tyre nga personat përgjegjës.

Dorëzimin e një kopje të rregjistrimit, çdo fundvit në arkivin e bashkisë.

Rakordimin e të dhënave të njësisë përgjegjëse për shërbimin e varrimit me zyrën e gjendjes civile, çdo tremujor.

Mbajtjen e rregjistrimit në formë elektronike, për të lehtësuar orientimin e qytetarëve në gjetjen e të afërmeve të tyre në varreza.

Kryerjen e aktiviteteve të kontrollit mbi përpunimin e informacionit.

Vlerësimin e herëpashershëm të punës për plotësimin e përgjegjësive në shërbimin e varrezave publike.

Hartimin e një programi për monitorimin e aktiviteteve.

Hartimin e plan buxhetit duke pasur parasysh përcaktimin e nevojave sipas përlllogaritjeve të sakta në preventiva.

Llogaritja në preventiv e zërit “Konsum i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve”.

- Institucioni Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, që përfshin shërbimin e përkujdesjes sociale publike për personat e identifikuar që kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme dhe administrimin e aseteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve, ka rezultuar me mangësi në:

Mungesën e rregullores së brendshme të funksionimit sipas kërkesave të ligjit nr.10296, dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Identifikimin e problemeve dhe situatave që rritin rrezikun dhe pamundësojnë realizimin e objektivave, nga personat përgjegjës.

Mungesën e aktiviteteve të kontrollit.

Miratimin dhe vënien në funksion të sistemit të menaxhimit të informacionit dhe komunikimit.

Hartimin e programit për monitorimin e aktiviteteve.

Pasqyrimin e të gjitha procedurave të prokurimit, përfshi edhe ato të realizuara në formë shkresore, në rregjistrat e parashikimit dhe realizimit.

Përditësimin e formularëve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël sipas udhëzimit përkatës.

Mënyrën e llogaritjes së fondit limit për punë ndërtimore sipas cmimeve të manualit teknik të ndërtimit.

Ndarjen e detyrave për zyrtarët e prokurimit në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, dt.08.07.2010 “Për menaxhmin financiar dhe kontrollin”.

Planifikimin e detajuar të shpenzimit të fondeve sipas klasifikimit buxhetor në nivel artikulli.

Zbatimin e detyrave të nëpunësit zbatues në mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

Përshkrimin e veprimeve në ditarët e kontabilitetit të të gjithë elementeve të përcaktuar në ligjin “Për kontabilitetin”.

Hartimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve.

Hartimin e bilancit paraprak verifikues.

Hartimin nga nëpunësi zbatues të listës së aktiveve në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël.

Përpilimin e raportit nga komisioni i inventarizimit për kushtet e ruajtjes së aktive dhe probleme të tjera që dalin gjatë procesit të inventarizimit.

- Sektori i Integritetit Europian, strukturë brënda bashkisë, krijuar në vitin 2019, ka detyra për implementimin e projekteve me fondet e BE-së. Në vitin 2022 është kryer angazhimi i auditimit për projektin “**Leading the Way to improve energy efficiency in public schools and propagate the use of renewable energy sources**” –, quajtur shkurt LED, me donator European Union. Në implementimin e këtij projekti kanë rezultuar mangësi në:

Plotësimin e vendeve vakante në sektorin e Integritetit Europian.

Hartimin e rregullores së brendshme për sektorin e Integritetit Europian.

Respektimin e afatit 6 mujor të raportimit të ecurisë së projektit në sistemin MIS, për të përfituar sa më shpejt fondet;

Rregjistrimin e shpenzimeve në sistemin MIS me kursin INFOREURO të muajit kur është lëshuar fatura nga operatori ekonomik.

Ndjekjen, realizimin dhe raportimin e të gjithë zërave të shpenzimeve.

Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e projekteve me fondet e BE.

- Fusha e shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura, për të cilën janë kryer angazhime auditimi edhe në vitet e mëparshme, ka pasur përmirësime të dukshme.

Detyrimet e mbetura në fund të vitit 2021 janë për shumën **11.6 milion lek**, në fund të 9 muajit 2022 kapin vlerën **4.4 milion lek**. Vlerësohet nga auditimi një ulje e ndjeshme.

Në përfundim të angazhimit kanë rezultuar mangësi në:

Garantimin nga nëpunësi zbatues i planifikimit të saktë të shpenzimeve dhe rishpërndarjes së fondeve për dy subjekte Korça Gaz me vlerë 152.585 lek dhe Sokrat Qirjako për shumën 4.066.591 lek.

Sigurimin e gjurmës së auditit nga drejtorja e përgjithshme e financës për detyrimin ndaj Sokrat Qirjako.

Rregjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve të prapambetura në ditarët kontabël të insitucionit “Shtëpia e foshnjës”.

Rakordimin e detyrimeve me OSHE dhe Filialin e postës nga NA dhe NZ të insitucionit Shtëpia e Foshnjës.

Garantimin e disponibilitetit të fondeve brënda vitit 2022 për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për Korça Gaz dhe Sokrat Qirjako me bashkëpronarët.

Marrjen e masave nga institucioni Shtëpia e Foshnjës për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për 5 subjekte në vlerën 138.853 lek.

Hartimin e planit të shlyerjes së detyrimeve tmungesën e programeveë prapambetura për vitin korrent dhe afatmesëm nga insitucioni Shtëpia e Foshnjës.

Nga analiza e treguesve rezulton se është rritur eficiency e veprimtarisë audituese. Rezultatet e këtij raporti mbështesin konkluzionin për një rritje të dukshme të performancës dhe cilësisë së veprimtarisë audituese në plotësimin e misionit të saj të ngarkuar me ligj, si dhe në përqëndrimin e kohës më të madhe të auditimit, tek fushat me risk të lartë dhe tek trajtimi i tyre.

- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve**

Natyrë e rekomandimeve i referohet gjetjeve dhe karakteristikave të njësive të audituara, të cilat janë të detajuara në pasqyrat nr.3 dhe nr.4 bashkëlidhur raportit. Gjetjet e auditimit i referohen parregullsisë, shkeljeve dhe mangësive në të gjitha fushat e audituara si: Drejtoria e Prokurimeve në bashki, Shërbimi i varrimit publik, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, Sektori i Integritimit European për projektin “Leading the Way to improve energy efficiency in public schools and propagate the use of renewable energy sources” financuar nga fondet e BE, dhe fusha e shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura

Gjetjet sipas fushave të mësipërme janë grupuar në sistemet e :

- Sistemi i Prokurimeve blerjeve dhe investimeve për :
Mungesën e programit për monitorimin e aktiviteteve.
Mangësi në llogaritjen e saktë të fondit limit për zërin “transport dru zjarri me kafshë”.
Moszbatim të kërkesave ligjore në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë nga KVO.
Moszbatim të dispozitave ligjore në caktimin e personave përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave.
Mosrespektim të kërkesave ligjore për prokurimin e blerjeve me vlerë të vogël për grupmallrash, apo shërbime e punë të ngjashme.
Llogaritje të gabuar të fondit limit për shërbimin publik të varrimit me përfshirjen në fond të zërrit “konsum i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevoja të qytetarëve”.
Mospasqyrim në rregjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve të të gjithë procedurave, përfshi edhe ato në formë shkresore.
Përdorim të formularëve jostandart në blerjet me vlerë të vogël.
Llogaritjen e gabuar të fondit limit për punime, nga mosrespektimi i cmimeve të manualit teknik të ndërtimit.
Moszbatim të ligjit për prokurimet dhe MFK, në ndarjen e detyrave të zyrtarëve të prokurimit.
Mospërgatitje të planit të detajuar të shpenzimeve, që në fillim të vitit, sipas klasifikimit buxhetor, deri në nivel artikulli.
Mosplanifikim i saktë i shpenzimeve nga bashkia për likuidimin e faturave të dy subjekteve, Korça Gaz me vlerë 152.585 lek dhe Sokrat Qirjako me bashkëpronarët me vlerë 4.066.591 lek.
Mosmarrje masa nga Shtëpia e Foshnjës për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të faturave për 5 subjekteve me vlerën 138.853 lek.
- Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione për: s’ka
- Sistemi i përkujdesjes shoqërore për : s’ka
- Sistemi i tatim taksave për : s’ka
- Sistemi i administrimit të pronës dhe pasurisë për :

Mosrespektimi i strukturës së miratuar në drejtorinë e prokurimeve, në drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave dhe në Sektorin e Integritit European.

Mosvlerësimi i mungesës së numurit të punonjësve si faktor që rrit riskun për përmbushjen e objektivave.

Mungesa e detyrave e përgjegjësive në rregulloren e brendshme të funksionimit për shërbimin e varrimit.

Mosrregjistrimi në hipotekë, si pronë e bashkisë, e varrezave publike.

Mungesa e aktiviteteve të kontrollit mbi përpunimin e informacionit nga punonjësit përgjegjës për shërbimin e varrimit.

Mosvlerësimi i herëpashershëm i punës për plotësimin e përgjegjësive në shërbimin e varrimit.

Mungesa e një programi për monitorimin e aktiviteteve në Shërbimin e varrimit dhe QRZh.

Përrllogaritje të pasakta në planifikimin e buxhetit, sipas nevojave për shërbimin e varrimit.

Mosrespektimi i kërkesave ligjore në hartimin e rregullores së funksionimit të QRZH.

Mungesa e identifikimit të problemeve që rritin riskun nga personi përgjegjës në QRZh.

Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të nëpunësit zbatues për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

Mungesa e përshkrimit të veprimve në ditarë sipas ligjit për Kontabilitetin.

Mungesa e hartimit të rregullave për menaxhimin e aktiveve në QRZh.

Mungesa e hartimit të bilancit verifikues paraprak në QRZh.

Mungesa e hartimit nga nëpunësi zbatues i QRZh i listës së aktiveve në bazë të të dhënave të rregjistrave kontabël.

Mungesa e hartimit të raportit lidhur me inventarizimin e pasurisë së QRZH nga komisioni i inventarizimit.

Mungesa e detyrave e përgjegjësive të punonjësve në sektorin e Integritit European.

Mungesa e identifikimit të risqeve në fushën e realizimit me sukses të projekteve të financuara nga donatorë të huaj.

Mungesa e gjurmës së auditit për detyrimin financiar në favor të Sokrat Qirjako dhe bashkëpronarët.

Mosmarrja e masave nga Shtëpia e foshnjës për rregjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve të prapambetura.

Mungesa e rakordimeve me OSHEE dhe Filialin e Postës nga Shtëpia e Foshnjës, për detyrimet financiare.

Mosgarantimi nga nëpunësi zbatues i një planifikimi të saktë të shpenzimeve edhe në rishpërndarjen e fondeve.

Mungesa e hartimit të një plani shlyerje të detyrimeve financiare nga Shtëpia e foshnjës.

- Sistemi i konfirmimeve të tjera :

Mungesa e rregjistrimit të shërbimeve të varrimit në dy rregjistra me nënshkrimet përkatëse.

Mosdorëzimi në arkivin e bashkisë në çdo fundvit, e një kopje të rregjistrimit të varrimeve.

Mosrakordimi i varrimeve çdo tremujor me zyrën e gjndjes civile.

Mungesa e mbajtjes së rregjistrimit të varrimeve në formë elektronike.

Mungesa e aktiviteteve të kontrollit në QRZH.

Mosfunksionimi i sistemit të informacionit dhe komunikimit në QRZh.

Mosrespektimi i afatit 6 mujor të raportimit në sistemin MIS të shpenzimeve të kryera për projektet me fondet IPA.

Mosrespektimi i kursit të këmbimit INFOREURO, sipas muajit të lëshimit të faturës nga operatori ekonomik, në raportimin e shpenzimeve.

Mosndjekja dhe mosrealizimi i të gjithë zërave të shpenzimeve.

- Sistemi i konfirmimeve të tjera me karakter organizativ : s'ka

Për vitin 2022, nuk janë evidentuar gjetje me dëm ekonomik.

- **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.**

Për vitin 2022, në të gjitha subjektet e audituara është bërë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm, procedurave të vendosura për funksionimin e mirë të këtyre sistemeve.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është përqëndruar tek procedurat e vendosura dhe të zbatuara për sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemin e pagesave, sistemin e administrimit të pronës e pasurisë, ndarjen e detyrave e përgjegjësi për çdo punonjës, rregullat për kontrollin dhe monitorimin e punës së cdo punonjësi, identifikimin e risqeve dhe aktivitetet e kontrollit të vendosura për uljen e tyre, përgatitjen e regjistrit të riskut nga cdo strukturë, vendosjen e linjave të komunikimit e raportimit për ndjekjen e realizimit të objektivave.

- **Çështjet e dërguara për investigim.**

Gjatë vitit 2022 njësi e AB e Bashkisë Korçë nuk ka dërguar asnjë çështje për investigim.

V. Rekomandimet

- **Rekomandimet e propozuara**

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjithësej 6 angazhime auditimi. Natyra e rekomandimeve i referohet gjetjeve dhe karakteristikave të njësisë të audituara, të cilat janë të detajuara në pasqyrën nr.5 bashkëlidhur raportit.

Gjetjet e auditimit i referohen parregullsive, shkeljeve dhe mangësive në fushat e audituara. Rekomandimet janë dhënë kryesisht në përmirësimin e :

- *Sistemit të prokurimeve, blerjeve dhe investimeve nëpërmjet*

Hartimit të një programi, nga drejtoria e prokurimit, për monitorimin e aktiviteteve duke patur parasysh faktorët kryesorë të tij: monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve; vlerësimin e herëpashershëm të tyre; raportimin e mangësive të konstatuara, për të garantuar se punonjësit po i zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet.

Kërkimit të asistencës teknike nga institucionet hartuese dhe miratuese të akteve ligjore, lidhur me hartimin, miratimin e udhëzimeve, apo manualeve teknike, për llogaritje të sakta të vlerave në zërat e prodhimit të druve të zjarrit sidomos në zërin: transporti dru zjarri me kafshë pasi llogaritjet janë teorike.

Përzgjedhjes nga KVO, të operatoreve ekonomikë fitues sipas kërkesave të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik” nenit 66, pika 5, paragrafi 2, i ndryshuar.

Zbatimit të dispozitave ligjore, sipas të cilave autoriteti kontraktor duhet të ketë në vëmendje që anëtarët e njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit ose anëtarët e KVO, njëkohësisht, nuk duhet të caktohen përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, të kësaj procedure.

Zbatimit me përpikmëri nga njësi e prokurimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, për të prokuruar ose parashikuar procedura prokurimi për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor, apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.

Marrjes urgjente të masave, për të hequr nga preventivi zërin, “Konsum i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve” dhe pagesa e faturave të kryhet sipas procedurave normale të shpenzimeve për konsumin e ujit.

Marrjes urgjente të masave nga QRZH për pasqyrimin e gjithë procedurave të prokurimit të realizuara gjatë viti kalendarik, pavarësisht nga fakti që nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik.

Përditësimi të formularëve nga QRZH në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël sipas formateve bashkëlidhur udhëzimit nr.5, dt.25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Llogaritjes nga QRZH të fondit limit ne fushen e ndërtimit ose fusha të tjera specifike, nga struktura të posacme ose kjo detyrë t'i ngarkohet specialistit të fushës më qëllim përlllogaritje të sakta të vlerave në zërat e punimeve, pasi llogaritjet e bëra ne prokurime të kësaj fushe nuk janë ne përputhje me: nenin 76, mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit sipas VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Rregullat e Prokurimit Publik” rrjedhimisht as me VKM nr.568, datë 25.06.2013, Manuali cmimeve teknike te ndertimit

Zbatimin nga QRZH të ligjit 10296, dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, “Veprimtaritë e kontrollit”, pika 3, gërma b), sipas të cilit titullari i autoritetit kontraktor për procesin e prokurimeve duhet të ketë në vëmendje ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

QRZH në procesin e planifikimit të buxhetit vjetor duhet të përgatite një plan të detajuar të shpenzimit të fondeve sipas klasifikimit buxhetor deri në nivel artikulli.

Marrjes së masave nga nëpunësi zbatues për të garantuar planifikim të saktë të shpenzimeve me qëllim likuidimin e faturave për Subjektin Korca Gaz me objekt ”gaz per ngrohje Markata e shijes”, fatura nr.158, datë 27.12.2019, vlera për tu likujduar 152,585 lekë dhe për Sokrat Qirjako me Bashkëpronarët përfitues të detyrimit sipas -Vend.Nr.2854, dt.31.10.2019, vlera për likuidim 4,066,591 lekë.

Marrjes së masave nga Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, për të likujduar detyrimet e prapambetura të krijuara në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2019, për shërbime dhe mallra të blera nga 5 subjekte me vlerën 138 853.

- *Sistemit të administrimit të pronës e pasurisë nëpërmjet*

Strukturimit të drejtorisë së prokurimeve sipas urdhërave të miratuar në vitet respektive.

Vlerësimi që paplotësia dhe mungesa e numurit të punonjësve për drejtorinë e prokurimeve, rit risqet për mospërbushjen e objektivave dhe rezultateve të kërkuara, si rjedhojë bie efica dha efektiviteti i burimeve njerëzore në dispozicion të saj.

Strukturimit të drejtorisë së menaxhimit të kontratave të infrastrukturës dhe të tjera, sipas urdhërave të miratuar në vitet respektive. Të plotësohet numuri sipas konstatimeve në raportin e auditimit.

Përditësimi të rregullores së Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike për pozicionin e kartelistes, të përshkruhen të gjitha proceset e punës dhe detyrat që parashikojnë ligjet për shërbimin e varrimit, mbasi mangësia rit risqet për mospërbushjen e objektivave dhe rezultateve të kërkuara.

Bashkëpunimit të Drejtorisë së MKI-së me Drejtorinë Juridike, përgjegjëse për regjistrimin dhe inventarizimin e pronave të paluajtshme në bashki, të bëjë identifikimin dhe regjistrimin e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve, si pronën e saj. Kjo pronë të paiset me çertifikatë pronësie.

Kryerjen e aktiviteteve të kontrollit, kontrole mbi përpunimin e informacionit, kontrole fizike, si dhe rishikimin e treguesve për matjen e performancës, të punonjësve të shërbimit të varrimit.

Vlerësimi të herëpashershëm i punës, për plotësimin e përgjegjësive në shërbimin e varrezave publike dhe varrezat e dëshmorëve dhe evidentimin e mangësive, për të bërë të mundur përmbushjen me efektivitet të kërkesave ligjore dhe kërkesave specifike të kontratës.

Hartimin e një programi për monitorimin e aktiviteteve në Shërbimin e varrimit, duke patur parasysh faktorët kryesorë të tij, monitorimi i vazhdueshëm i aktiviteteve; vlerësimin e herëpashershëm të tyre dhe raportimin e mangësive të konstatuara, për të garantuar se punonjësit po i zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet.

Hartimit të një plan buxheti për shërbimin e varrimit, duke patur parasysh që nevojat të përcaktohen sa duhen, përlllogaritjet në preventiva të bëhen të sakta, të studjuara mirë, për të garantuar përdorimin e fondeve me efektivitet dhe efikasitet.

Përshtatjes dhe miratimit të rregullores së funksionimit të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. neni 9, pika 4, gërma a, si dhe Manuali MFK.

Identifikimit nga personi përgjegjës në QRZh, të problemeve dhe situatave që ritin rrezikun dhe pamundësojnë realizimin e objektivave për drejtorinë.

Hartimin e një programi për monitorimin e aktiviteteve nga QRZH, duke patur parasysh faktorët kryesorë të tij, monitorimi i vazhdueshëm i aktiviteteve; vlerësimin e herëpashershëm të tyre dhe raportimin e mangësive të konstatuara, për të garantuar se punonjësit po i zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet.

Zbatimit nga QRZh të kërkesave ligjore të gërmasë 3, të nenit 12 të ligjit nr.10296, dt.08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, sipas të cilave nëpunësi zbatues përgjigjet për: mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimin për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat dhe standartet e vendosura.

Përshkrimin të veprimeve, nga NZ i QRZH dhe regjistrimet në ditarët e hyrjeve - daljeve, të përmbajnë të gjitha elementët e përcaktuar në pikën 2, të nenit 7, të Ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (origjina, natyra, data, përmbajtja).

Zbatimit nga titullari i QRZh të pikës 5, Kapitulli I, Udhëzimi Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe neni 8, pika 8, germa (ç) e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, sipas të cilit drejtuesit duhet të hartojnë rregulla për menaxhimin e aktiveve, të cilat duhet të përcaktojnë : Procedura për administrimin e vlerave materiale e monetare me qëllim pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve të vlerave në ruajtje e në përdorim, që ato të mos dëmtohen e shpërdorohen.

Hartimit nga QRZh të bilancit verifikues paraprak, pas rregjistrimeve të kryera në mënyrë kronologjike në ditarët e kontabilitetit, pasi të kryhen procedurat e rakordimit, sistemit të diferencave dhe veprimet e mbylljes së llogarive nga nëpunësi zbatues.

Zbatimit të pikës nr.81, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas të cilës nga nëpunësi zbatues i QRZH-së të hartohet lista e aktiveve në bazë të të dhënave të rregjistratve kontabël të aktiveve të njësisë.

Zbatimit nga komisioni i inventarizimit të QRZH, të kërkesave të pikës 85/c, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, për përpilimin e një raporti lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, kushtet e ruajtjes së tyre e të tjera probleme të dala gjatë procesit, dhe së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Marrjen e masave urgjente për të plotësuar vendet vakante në Sektorin e Integritimit Europian, e sipas strukturës së miratuar nga kryetari i bashkisë.

Hartimit dhe miratimit nga titullari të rregullores së brendshme të Sektorit të Integritimit Europian, duke e plotësuar me ndryshime në emërtime sipas strukturës së miratuar, me përshkrime të misionit dhe objektivave, me detyrat e përgjegjësitë në sektorë dhe pozicione të caktuara, sipas konstatimeve në raportin e auditimit, duke respektuar detyrimet që lindin nga zbatimi i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, gërma a, si dhe Manualin për MFK.

identifikimit dhe vlerësimit të risqeve që rrezikojnë realizimin me sukses të projekteve me fondet IPA. Të hartohet rregjistër risku, të evidentohen masat për menaxhim e risqeve me qëllim minimizimin dhe eliminimin e tyre. Rregjistri i riskut i Sektorit të Integritimit Europian të bëhet pjesë e rregjistrit të riskut të bashkisë.

Sigurimit të gjurmës së auditit Nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, për mos marrëveshjen e Sokrat Qirjakos me bashkëpronarët për ndarjen e pjesëve takuese dhe të punohet që detyrimi i prapambetur i vendimit gjyqësor të mbyllet brenda vitit 2022.

Marrjen e masave nga institucioni në varësi të bashkisë Korçë, Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, për regjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve të prapambetura, në 9 raste në regjistrat kontabile të miratuara, mbështetur në nenin 3, pika 1 e ligjit nr 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Zbatimin e kërkesave për rakordimin e detyrimeve me OSHEE dhe Filialin e Postës, nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, i Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla”.

Garantimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK në rialokimet e buxhetit gjatë vitit 2022, në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimin Plotësues të zbatimit të buxhetit vjetor, për mbulimin me shpenzime për dy detyrimet e prapambetura të pa likujduara, detyrimin e krijuar në vitin 2019, për Sokrat Qirjako dhe Bashkëpronarët, (vendim gjyqësor) në vlerën 4,006,591 lekë dhe detyrimin e krijuar në vitin 2019, për “Korça Gaz” (mallra) në vlerën 152,585 lekë.

Hartimit nga Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”, të planit të shlyerjes detyrimeve të prapambetura për vitin korrent e afatmesëm referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 4.6.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithëshme në llogari të thesarit”.

- *Sisteme të tjera nëpërmjet*

Rregjistrimit nga njësia përgjegjëse, e çdo shërbimi varrimi në dy regjistra të njëjtë, numuri i faqeve të të cilave vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkisë”.....Regjistri nënshkruhet në çdo fletë nga përgjegjësi i shërbimit.

Dorëzimit nga njësia përgjegjëse çdo fund viti, të njëjës prej kopjeve të rregjistrat në arkivin e bashkisë, ndërsa kopja tjetër mbetet në ruajtje pranë shërbimit të varrimit.

Rakordimit të regjistrave çdo tremujor, nga njësia përgjegjëse për shërbimin e varrimit me zyrat e gjëndjes civile.

Mbajtjes nga njësia përgjegjëse të rregjistrat të varrimimeve edhe në formë elektronike, me qëllim që të jetë i hapur për qytetarët, të cilët kërkojnë të orientohen për të gjetur të afërmit e tyre në varreza.

Kryerjen nga QRZh të aktiviteteve të kontrollit, kontrole mbi përpunimin e informacionit, kontrole fizike, si dhe të dhe rishikohen treguesit për matjen e performancës.

Miratimit dhe vënies në funksion nga QRZh të sistemit të menaxhimit të informacionit dhe komunikimit.

Respektimit të afatit 6 mujor të raportimit për ecurinë e aktiviteteve dhe shpenzimeve të projektit në sistemin MIS, me qëllim përfitimin sa më shpejt të fondeve.

Rregjistrimit të shpenzimeve në sistemin MIS, me kursin INFOREURO të muajit kur është lëshuar fatura nga operatori ekonomik, në mënyrë që të reduktohen diferencat midis buxhetit të aprovuar dhe shpenzimeve të kryera në fakt, për shkak të kursit të këmbimit.

Ndjekjes, realizimit dhe raportimit të shpenzimeve për të gjithë zërat e buxhetit të aprovuar, pavarësisht nga vlera e tyre, për të përthithur të gjitha fondet e projektit. Në rastin e projektit LED shpenzimet në zërin “Office and Administration” janë zero, megjithëse ky zë duhej llogaritur në proporcion me shpenzimet e tjera të projektit.

- **Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit**

Për vitin 2022 janë propozuar gjithësej 48 rekomandime, nga të cilat :

- ✓ Për përmirësimin e sistemeve janë propozuar 48 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. 22 rekomandime janë realizuar dhe 26 janë në proces për arësye kryesisht, të njohjes së strukturave me bazën ligjore, të zbatimit të tyre në punën dhe dokumentacionin e vitit 2023, të plotësimit të strukturave me punonjësit e miratuar dhe të bashkërendimit të punës midis strukturave.

Për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2021, nga 36 rekomandime gjithësej kanë duke mbetur në proces zbatimi vetëm 11 rekomandime, që mbeten për verifikim në auditimin e radhës të subjekteve përkatëse.

Drejtimi ka planifikuar punën për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit me angazhime auditimi specifike, në fillim të vitit 2023, për tu siguruar se njësitë kanë ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve apo masave korrigjuese e këshillave të auditimit.

Duke e vlerësuar të rëndësishëm dhe qëllim final të auditimit zbatimin e rekomandimeve, në vijim do vijojë bashkëpunimin me njësitë e audituara, me qëllim që :

- Rekomandimet të jenë të qarta, të plota, dhe të ndihmojnë subjektin në përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive.
- Rekomandimet të diskutohen dhe pranohen që gjatë fazës së përgatitjes së Projekt raportit të auditimit, duke rënë dakord për përshfirjen e tyre në Raportin Përfundimtar të auditimit.
- Të diskutohet dhe bashkëpunohet me subjektet e audituara mbi planin e veprimit paraprak.
- Rekomandimet e AB të përfshihen në rregjistrin e riskut të subjektit dhe të bashkisë si ngjarje që rrezikojnë realizimin e objektivave.
- Të respektohet afati ligjor i raportimit të masave të marra nga subjekti i audituar.
- Caktimin e një zyrtari përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin e realizimit të tyre.

VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë

Struktura audituese është përpjekur të kryejë monitorimin e sistemit dhe sigurimin e cilësisë në të gjitha fazat e kryerjes së auditimit, pra që në planifikim, zbatim dhe raportim. Sigurimi i cilësisë është bërë nga drejtuese e njësisë, nëpërmjet plotësimit të formateve standarte për të gjitha fazat me informacion cilësor, sipas *Programit për sigurimin e brendshëm të cilësisë të AB* për bashkinë Korçë, të përditësuar dhe të miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.376, dt.28.05.2021.

Reagimet e marra nga pala e audituar janë pjesë e dosjes së auditimit dhe janë mbajtur parasysht për përmirësimin e punës audituese. Janë përgatitur formularët e kontrollit të cilësisë sipas Manualit të ri.

VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese

- **Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB**

Problematikat e punës audituese, të evidentuara gjatë vitit 2022 kanë qënë :

- Përditësimi i njohurive më kërkesat e Manualit të ri për AB kërkon kohë dhe trajnim të specializuar.
- Mungesa e plotësimit të strukturës së AB sipas numurit të miratuar, 4 auditues.
- Mungesa e punonjësve të çertifikuar dhe me përvojë në auditim.
- Ndryshimet e shpeshta të akteve ligjore vështirësojnë punën audituese.

- **Kapacitetet audituese**

Drejtorja e auditimit në Bashki ka strukturë : 1 Drejtor, 3 Specialistë, gjithësej 4 punonjës.

Për vitin 2022 kanë punuar 3 audite, 2 auditue të çertifikuara dhe 1 audituese e re, e paçertifikuar.

Vartësia e njësisë së auditimit është nga Titullari i Institucionit (Kryetari).

Arsimi profesional i punonjësve është: 1 ekonomiste finance dhe 1 ekonomiste plani dhe 1 ekonomiste finance-kontabilitet, në përputhje me kriteret e përcaktuara me përshkrimet e vendeve të punës që aplikohet për strukturat e auditimit. Niveli profesional i drejtores dhe i një auditeje është shumë i mirë.

Burimet e auditimit janë përdorur në përputhje me planifikimin.

- **Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve**

Drejtores dhe drejtorisë dhe një audite kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm online për vitin 2022. Ky trajnim u zhvillua nga DHAB.

- **Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve**

Kosto në fakt e auditimeve për vitin 2022, në mijë lekë, përfshin:

Paga dhe sigurime shoqërore	2.804 mijë lekë
Dieta	67 mijë lekë
Te tjera kancelari, bojë	<u>40 mijë lekë</u>
Gjithësej kosto vjetore	2.911 mijë lekë

Burimet janë shpërndarë : 567 ditë pune për 3 persona, mesatare 189 ditë pune për person.

VIII. Konkluzione

- **Konkluzione mbi problematikën e punës audituese**

Rezultatet e këtij raporti mbështesin konkluzionin për problematika të hasura gjatë punës audituese kryesisht tek :

- Vendosja dhe miratimi i rregullave të MFK.
- Vendosja e objektivave konkrete për çdo fushë të veprimtarisë së bashkisë.
- Identifikimin e risqeve dhe përgatitja e rregjistrit të riskut.
- Hartimi i strategjisë së menaxhimit të riskut.
- Përditësimi i rregulloreve të brendshme.
- Listat e proceseve të punës dhe përshkrimi i detyrave e përgjegjësive, duke përmbushur të gjitha funksionet ligjore.
- Vendosjen e aktiviteteve të kontrollit për informimin, komunikimin dhe monitorimin e veprimtarisë.
- Hartimin e rregjistrave të aktiveve, përditësimin e tyre.
- Gjurmët specifike të auditit për menaxhimin e aktiveve.

Problematikat e hasura janë vlerësuar nga audituesi si fushat më me rrisht dhe janë trajtuar duke u kushtuar më shumë kohë.

Janë realizuar 6 angazhime auditimi për vitin 2022, nga 6 të planifikuara. Janë të evaduar 5 auditime. Mbi bazën e raporteve finale të auditimit dhe planit të masave ka filluar puna për zbatimin e rekomandimeve e detyrave të angazhimeve të auditimit.

- **Prioritetet për vitin në vazhdim**

1. Plotësimi i njësisë me personel të aftë në fushën auditimit.
2. Zbatimi i rekomandimeve të adresuara nga auditimi i Bashkimit Europian për veprimtarinë dhe kapacitetet e AB në sektorin public.
3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga grupi i punës i DHAB për vlerësimin e jashtëm të cilësisë.
4. Përmirësimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Kjo kërkon nga njësitë e audituara, caktimin e një anëtari të stafit të ngarkuar me ndjekjen procesit në tërësi në lidhje me :

- Sigurimin që sistemi i bashkëpunimit të ndjekjes së rekomandimeve të auditimit është i dokumentuar dhe në mënyrën e duhur.
 - Sigurimin se është kthyer përgjigje në kohën e duhur dhe për të gjitha rekomandimet e dhëna nga auditimi.
 - Sigurimin për marrjen e të gjitha veprimeve korigjuese në zbatim të rekomandimeve.
 - Zgjidhjen e të gjitha mosmarëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.
5. Përditësimi i dosjeve të përhershme të subjekteve.
 6. Kryerja e auditimeve me nivel të lartë profesional, rritja e cilësisë së raportimit, rritja e nivelit profesional duke realizuar qëllimet dhe objektivat vjetore dhe strategjike.
 7. Shërbime Këshillimi për drejtori të bashkisë dhe subjektet e audituara, gjatë gjithë vitit.
 8. Ndjekjen e trajnimeve për ngritjen profesionale të audituesve.

Athinulla TREBICKA

Drejtuese e Njësisë

Korçë; 14 shkurt 2023